



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 371 Prot.

Tiranë, më datë 23.08.2024

VENDIM

Nr. 326, datë 23.08.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saç”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 23.08.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor – shkencor në vazhdim “Kërkime arkeologjike në territorin përreth Durrësit” me drejtues projekti Dr. Brikena Shkodra-Rrugia dhe Björn Forsén, me aplikues dhe zhvillues **Instituti e Albanologjisë**;
2. Para fillimit të projektit të bëhet njoftim zyrtar pranë IKTK-së dhe DRTK-së përkatëse;
3. Pas përfundimit të projektit, një kopje e dokumentacionit si dhe lista e gjetjeve arkeologjike të depozitohen pranë IKTK-së, DRTK-së dhe IKRTK-së;
4. Dokumentacioni i hartuar në kuadër të këtij projekti të dorëzohet pranë IKTK-së;
5. Afati i përfundimit të punimeve do të jetë sipas planit të punës të depozituar në IKTK;
6. Drejtuesi i projektit duhet të marrë masa për publikimin e rezultateve në përputhje me afatet e përcaktuara në Rregulloren e Arkeologut, miratuar me Vendim Nr. 2, datë 30.01.2009 të KKA-së, në lidhje me projektet kërkimore - shkencore;
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
8. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

